

# LETËR PËR HAPJEN E SHKOLLËS

*Letër për njoftimin e prindërve dhe nxënësve në përgatitjen e tyre për ditën e parë të shkollës, mbas procesit të mbylljeve, zhvendosjeve dhe shkrirjes së shkollave*



## Zyra e Shërbimeve për Nxënësit garanton mbështetje shëndetësore për nxënësit në tranzicion

Zyra e Shërbimeve për Nxënësit ka punuar me zell për lehtësimin e procesit të tranzicionit për nxënësit me probleme shëndetësore.

Qëllimi i zyrës është që të garantojë se nxënësit që marrin përkujdesje shëndetësore të sjelljes në shkollën e cila mbyllet, të marrin mbështetjen e kërkuar edhe në shkollën e tyre të re.

“Kjo bën që mësimet të jenë fokusi kryesor,” thotë Ericka Washington, Zëvendës Kryetare e Shërbimeve të Nxënësve dhe Tranzicionit.

Shumë shkolla pritëse do të ofrojnë Shërbimet Terapeutike të Shkollës (STS), që ofron për nxënësit e shkollave fillore e tetëvjeçare dhe familjet e tyre me



shërbimet e duhura për zhvillimin e social dhe emocional. Shërbimet janë pjesë e rëndësishme e ditës shkollore për shumë fëmijë, prandaj edhe Drejtoria Arsimore ka siguruar STS në disa shkolla pritëse.

Shërbimet Terapeutike të Shkollës ofrohen gjatë ditëve të regullta shkollore dhe përfshijnë sesione terapie individuale dhe në grup, si edhe ndërhyrje dhe konsultime kokë-më-kokë me Punonjës të Shëndetit të Sjelljes. E konceptuar për objektiva specifike të sjelljes, që trazohen me aftësinë mësimore të fëmijës, STS synon krijimin e një mjedisi që nxit sjellje optimale e të shëndetëshme.

Shërbimet Terapeutike të Shkollës financohen dhe drejtohen nga “Community Behavioral Health” (CBH), një agjenci e qytetit. Drejtoria Arsimore do të implementojë dhe mbajë Shërbimet Terapeutike të Shkollës në shkollat pritëse të mëposhtëme: Julia deBurgos, William McKinley, John F. Hartranft, Tilden Middle School, William Dick, W.D. Kelley, E.M. Stanton, Tanner Duckrey, Abigail Vare, Rhodes, Ethel Allen, Morris, Potter Thomas, Penn Treaty, Emlen, Wister, Leeds, Rowen, Pennypacker, Pennell, Wagner, Childs, Arthur, Longstreth, Blankenburg, dhe Heston.

Për më tepër informacion rreth programit, ju lutemi telefononi CBH në numrin 888-545-2600.



## Si po punojmë?

Pasqyrë e progresit të Drejtorisë në përgatitjen e shkollave pritëse për vitin e ri shkollor:

### Përqindja e ...

Nxënësve që kërkojnë shërbime të specializuara, që u është ofruar mundësia të vizitojnë shkollat e tyre pritëse	100%
---	------

Shkollave pritëse me mjediset e përmirësuara, të plotësuara	53%
---	-----

Shkollave pritëse me drejtor të caktuar për vitin tjetër	96%
--	-----

Nxënësve CTE, që janë caktuar në programe të ngjajshme, ose ekuivalente	100%
---	------

## Bashkëpunimi i Drejtorisë me “Springboard Collaborative” për ruajtjen e dijeve gjatë verës

Drejtoria do të fillojë një program gjatë verës me “Springboard Collaborative”, që të ofrojë një program shkrim leximi për nxënësit e shkollave tona fillore.

Studimet e kryera kanë konstatuar se nxënësit e shkollave fillore me të ardhura të ulta, pësojnë një rënie të madhe në lexim gjatë verës, dhe si rrjedhojë diferencat mësimore midis nxënësve të shkollave të mesme, lidhen kryesisht me harresën, që krijohet tek ata gjatë muajve të verës.

Modeli “Springboard” kombinon instruksionet për stimulimin e nxënësit me trajnimin e prindërve në një sistem të konceptuar për ngushtimin e dallimeve në shkrim lexim, për nxënësit nga klasat e katërta. Stimujt e nxënësit do të përfshijnë materiale mësimore si libra e paisje shkollore.

Springboard do të ndihmojë nxënësit të fitojnë aftësi në shkrim lexim të qëndrueshme, do të nxitin prindërit dhe mësuesit për bashkëpunim dhe ndihmojnë individët nga shkollat që mbyllen dhe ato pritëse, për ripërtëritjen e sensit të komunitetit, përpara fillimit të shkollës në Shtator. “Springboard Collaborative” do të operojë në shkollat më poshtë:



Springboard School:	Nxënësit Merren nga:
Blaine Elementary School	L.P. Hill Elementary School
Hartranft Elementary School	Ferguson Elementary School
McKinley Elementary School	Ferguson Elementary School
Duckrey Elementary School	M. Hall Stanton Elementary School

Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni [springboardcollaborative.org](http://springboardcollaborative.org).



- Njihni shkollën e fëmijës tuaj për 2013-14. Të gjithë nxënësit duhet të kenë marrë një letër nga Zyra e Caktimit dhe Regjistrimit të Nxënësve. Në rast se nuk keni marrë letër, ju lutemi telefononi 215-400-4290.
- Rishikoni kalendarin e vitit të ardhshëm shkollor. Kalendarin mësimor për vitin e ardhshëm është online në [www.philasd.org/language/albanian/calendar](http://www.philasd.org/language/albanian/calendar). Dita e parë e shkollës është datat 9 Shtator
- **Regjistrohuni për informacion dhe përditësime rreth procesit të tranzicionit.** Vizitoni <http://www.philasd.org/transitionlistserv> për më shumë informacion.
- Finalizoni planet e transportimit. Zyra e Shërbimeve të Transportit do të përcaktojë cilët nxënës do të kenë të drejtë për transport me mjetet e shkollës dhe SEPTA\_s, bazuar në kriteret e përcaktuara dhe politikën e Drejtorisë Arsimore. Në rast se kriteret plotësohen, ju do të merrni një letër gjatë verës nga Zyra e Shërbimeve të Transportit.
- Përgatitni Uniformat Shkollore. Nxënësit e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias duhet të mbajnë uniformë. Ju lutemi vizitoni , [www.philasd.org/schoolopening](http://www.philasd.org/schoolopening), për politikën e Drejtorisë për uniformat.
- Ndiqni Takimet Familja dhe Edukimi. Ejani në takim tonë Familja & Edukimi ditën e shtunë datë 10 Gusht nga ora 8 a.m. deri 5 p.m. për dhurata falas, seminare edukative, etj! Takimi do të zhvillohet në “School of the Future”, 4021 Parkside Ave.
- Ndiqni një Takim të Hapur (Open House): Zyra e Angazhimit të Familjes dhe Komunitetit ka planifikuar një Takim të Hapur në secilën shkollë pritëse. Lista e këtyre takimeve do të postohet në uebsajtin e Hapjes së Shkollës në mes të Korrikut.

## NSBE ofron programin veror STEM

Nxënësit e klasave të Treta deri të Pesta, ftohen të ndjekin programin "National Society of Black Engineers (NSBE) Summer Engineering Experience for Kids" (SEEK), një kamping falas tre javor në shkollën fillore "McDaniel Elementary", që thekson konceptet në matematikë dhe shkencë.

Pjesëmarrësit do të ballafaqohen me:

- \* STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë) përmes projekteve inxhinierike
- \* Nxënësit e Kolegjit STEM
- \* Rolet dhe përgjegjësitë e inxhinierëve

Në secilën javë, pjesëmarrësit e kampingut do të marrin një projekt të ri, duke kulmuar me projektimin dhe paraqitjen e plotë të tyre, në të cilën do të jenë të ftuar të gjithë prindërit.

SEEK është i hapur për nxënësit që janë aktualisht në klasat 3-5. Shkolla "McDaniel Elementary", është në adresën 1801 S. 22<sup>nd</sup> St. Për më tepër informacion, ju lutemi vizitoni [www.nsbe.org/seek.aspx](http://www.nsbe.org/seek.aspx), ose telefononi 215-400-5872.



# Telefonat më të përdorur

PYETJE PER...

KONTAKTONI

**Mbështetje dhe Pasurim Mësimor** 215-400-5902

Ofron udhëzime profesionale për mësuesit në fushat e muzikës, artit, vallëzimit, theatrit, fizikulturës, aktivitetet jashtëshkollore, librit dhe gjuhëve të huaja

**Frekuentimi dhe Mungesat** 215-400-4220

Ofron shërbime mbështetëse për shkollat, që të përmirësojnë frekuentimin dhe uljen e mungesave

**Edukimi Tekniko Profesional** 215-400-2331

Ofron programe dhe shërbime për nxënësit e përfshirë në Edukimin tekniko Profesional

**Fëmijëria e Herëshme** 215-400-4270

Ofron programe dhe shërbime për fëmijët e moshave 0-6 vjeç dhe familjet e tyre

**Angazhimi i Familjes & Komunitetit** 215-400-4180

Aftëson familjet dhe komunitetin për akses dhe përfshirje në programet dhe shërbimet e Drejtorisë

**Edukimi Shumëgjuhësh** 215-400-4240

Ofron shërbime dhe mbështetje shumëgjuhësore për nxënësit dhe familjet

**Caktimi i Nxënësit** 215-400-4290

Vlerëson kërkesat për transferim të nxënësit dhe përcakton shkollën e duhur

**Rekordet e Nxënësit** 215-400-4780

Mban dhe proçeson kërkesat për rekordet e nxënësve (transkripte, verifikime, kërkesa, rekordet e paaftësisë, etj.)

**Shërbimet e Specializuara** Ofron shërbime të edukimit special, mbështetjes së specializuar dhe të shëndetit të nxënësit 215-400-4170

**Siguria e Shkollës** 215-400-4710

Angazhohet me administratorët e shkollës, policinë, nxënësit, prindërit dhe pjestarët e komunitetit, për rritjen e sigurisë të nxënësve në mjediset e shkollës dhe përreth saj.

**Transporti** Ofron transport të sigurtë për nxënësit e Filadelfias, që ndjekin shkollat publike, private, charter, dhe ato fetare. 215-400-4350

Drejtoria Arsimore e Filadelfias

Ju lutem vizitoni websajtin tonë në gjuhën shqipe!  
[www.philasd.org/language/albanian](http://www.philasd.org/language/albanian)



LINJA DIREKTE NË GJUHËN SHQIPE  
ALBANIAN HOTLINE



Hezitoni të telefononi Drejtorinë Arsimore për shkak të vëzhgimeve gjuhësore?  
Nuk dini ku dhe kujt t'i drejtoheni për ndihmë?

Linja Direkte në Gjuhën Shqipe është zgjidhja juaj!

**215-400-8480**